



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-011

Prishtinë, më 12 dhjetor 2017, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 12 DHJETOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Slavko Simiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Fikrim Damka.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Formimi i Komisionit parlamentar për Stabilizim-Asociim ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në mbledhjen Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 5 dhjetor 2017, pasi është diskutuar lidhur me formimin e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim, është ngarkuar Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale që ta përgatisë një opinion ligjor.

Ai i njoftoi të pranishmit se opinioni ligjor u është shpërndarë anëtarëve të Kryesisë.

Kryetari konstatoi se delegacioni i Kuvendit të Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim do të përbëhet nga trembëdhjetë (13) deputetë, sipas kësaj ndarje: GP i LVV-së, 3 anëtarë; GP i LDK-së, 3 anëtarë; GP i PDK-së, 3 anëtarë; GP i Listës serbe, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i “Nisma për Kosovën”, 1 anëtar dhe GP “6+”, 1 anëtar.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me formimin e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim.

Lidhur me formimin e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim, diskutoi Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesia me votim unanim e miratoi përbërjen e delegacionit prej 13 anëtarëve të në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim.

Ndërsa, me shumicë votash (3 “për” dhe 1 “kundër”, nënkryetari Kujtim Shala), Kryesia vendosi që kryesuesi i delegacionit në këtë komision të jetë nga GP i PDK-së.

Në vazhdim, kryetari gjithashtu theksoi se zëvendëskryesuesi i delegacionit të Kuvendit në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim do të jetë nga deputetët e opozitës.

Pastaj, Kryesia lidhur me formimin e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Formohet delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë prej 13 anëtarëve, si në vijim: Grupi Parlamentar i LVV-së, 2 anëtarë, një zëvendëskryesues dhe dy zëvendësanëtarë; Grupi Parlamentar i

LDK-së, tre anëtarë dhe tre zëvendësanëtarë; Grupi Parlamentar i PDK-së, kryesuesi, dy anëtarë dhe dy zëvendësanëtarë; Grupi Parlamentar i Listë serbe, një anëtar dhe një zëvendësanëtar; Grupi Parlamentar i AAK-së, një anëtar dhe një zëvendësanëtar; Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën”, një anëtar dhe një zëvendësanëtar, dhe Grupi parlamentar “6 +”, një anëtar dhe një zëvendësanëtar.

2. Kërkohej nga grupet parlamentare që t’i propozojnë kryesuesin, zëvendëskryesuesin, anëtarët dhe zëvendësanëtarët në delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës deri më 14 dhjetor 2017.

2. Kërkesa për emërimin e delegacionit të përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (SEECP) për Legjislaturën VI

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 20 nëntor 2017, ka kërkuar nga grupet parlamentare që t’i propozojnë emrat e deputetëve për anëtarë dhe zëvendësanëtarë në delegacionin e përhershëm për Legjislaturën VI për pjesëmarrje në takimet e rregullta të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (SEECP).

Pas diskutimeve, Kryesia lidhur me emërimin e delegacionit të përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (SEECP) për Legjislaturën VI nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

I. Emërohet delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Legjislaturën VI në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore, në këtë përbërje:

1. Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesues i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

2. Komisioni i Përhershëm Qendror, deputeti nga GP i PDK-së, anëtar/e, deputeti nga GP i LS-së, zëvendësanëtar,

3. Komisioni për Ekonomi, Infrastrukturë dhe Energjetikë, deputeti nga GP i LDK-së anëtar, deputeti nga GP i AAK-së, zëvendësanëtar,

4. Komisioni për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Bashkëpunim për Siguri, deputeti/ja nga GP i LVV-së anëtar, deputeti nga GP i “Nisma”, zëvendësanëtar,

5. Komisioni për Zhvillim Social, Arsim, Hulumtim dhe Shkencë, deputeti/ja nga GP i LVV-së, anëtar, deputeti/ja nga GP “6+”, zëvendësanëtar.

II. Kërkohej nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për pozitën e lartshënuara.

Në mungesë të kuorumit, kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale